



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME Nr. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 06/07/2018

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

Drejtuar: Shoqërisë “A&T” sh.a me NUIS L32320008H dhe me adresë: Rruga “Ibrahim Rugova”, Kulla “Sky Tower”, Kati 7, Apartamenti Nr.3, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur.

Numri i referencës së procedurës/lotit: Loti I : REF-70234-05-21-2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje karburanti” LOTI I: Blerje diesel (gazoil), afati: Nga nënshkrimi i kontratës deri më datë 31.12.2018 sipas nevojave dhe kërkesave të Autoritetit Kontrator.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 21, Date 28 .05.2018.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Shoqëria “A&T” sh.a me NUIS L32320008H dhe me Çmim total i ofertës i paraqitur në marzh fitimi 14.4 (katërbëdhjetë pikë katër) %.
2. Shoqëria “DAS OIL” sh.a me NUIS L52230020G dhe me Çmim total i ofertës i paraqitur në marzh fitimi 8.8 (tetë pikë tetë) %.
3. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Kastrati” sh.p.k dhe “Kastrati” sh.a me NUIS J61813529P dhe K21711502V dhe me Çmim total i ofertës i paraqitur në marzh fitimi 9.4 (nëntë pikë katër) %.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria “DAS OIL” sh.a me NUIS L52230020G
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
 - a) Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 1.KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8 pasi nuk ka plotësuar deklaratën sipas shtojcës 8.
 - b) Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7; pasi nuk ka dorëzuar asnjë deklaratë.

c) **Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 1 tek Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument.

d) **Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 3 tek Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin (2017, 2018) edhe për vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit, sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument.

e) **Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3 Kapaciteti Teknik** pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për të vërtetuar përmbushjen e këtyre kriterëve.

2. **Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Kastrati” sh.p.k dhe “Kastrati” sh.a me NUIS J61813529P dhe K21711502V.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

a) **Bashkimi i Operatoreve Ekonomik nuk plotëson pikën Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin (2017, 2018) edhe për vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit, sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Pasi një nga antarët e B.O specifikisht Kastrati sh.p.k nuk ka paraqitur vertetim për shlyerjen e taksave vendore per vitin 2018.

b) **Bashkimi i Operatoreve Ekonomik nuk plotëson pikën Kapaciteti teknik**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka importuar dhe/ose tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2016 dhe 2017. Pasi një nga antarët e B.O specifikisht Kastrati sh.a nuk ka paraqitur vertetim për plotësimin e kësaj pike.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqërinë “A&T” sh.a me NUIS L32320008H me adrese Rruga “Ibrahim Rugova”, Kulla “Sky Tower”, Kati 7, Apartamenti Nr.3, Tiranë, se oferta e paraqitur në marzh fitimi 14.4 (katërmëdhjetë pikë katër) %, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga 5 Maji, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i kontratës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 28.06.2018.

Ankesa: Nuk ka.